



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKT LIGJ

“PËR POLICINË BASHKIAKE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon misionin, organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Policisë Bashkiake në Republikën e Shqipërisë, marrëdhëniet e punës së punonjësit të Policisë Bashkiake, si dhe masat për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike në komunitet.

Neni 2

Misioni

Policia Bashkiake ka si mision ushtrimin e funksioneve në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjes së punëve publike, miradministrimit të hapësirave publike dhe mbrojtjes së mjedisit në territorin e juridiksionit të saj.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Emërim i punonjësit të Policisë Bashkiake” është momenti i fillimit të marrëdhënieve juridike të punës për punonjësin e Policisë Bashkiake.
2. “Hapësirat publike” janë hapësirat e jashtme, si: trotuari, rruga, sheshi, lulishtja, parku e të tjera të ngjashme në shërbim të komunitetit, ku menaxhimi është publik ose privat, si edhe rrugëkalimet publike dhe mjediset që janë të hapura për publikun ose në shërbim të përdorimit publik, sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
3. “Ministri përgjegjës” është ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
4. “Normat etike detyruese të bashkëjetesës” është tërësia e rregullave që përcaktojnë sjelljen dhe marrëdhënien që janë të detyrueshme për t’u zbatuar nga bashkëpronarët, me qëllim ruajtjen e ekuilibrave të bashkëjetesës, sigurisë së qetësisë dhe veprimtarive të përditshme ekonomike e shoqërore, sipas përcaktimit në legjislacionin për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.
5. “Organi disiplinor” është eprori direkt dhe komisioni disiplinor, që shqyrtojnë kërkesat për

procedim disiplinor ndaj punonjësit të Policisë Bashkiake dhe vendosin për masën disiplinore sipas përcaktimeve të këtij ligji.

6. “Sjellja profesionale” ka kuptimin e realizimit të punëve me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara, duke respektuar etikën në punë, duke përmbushur objektivat e Policisë Bashkiake dhe duke krijuar marrëdhënie të mira pune me kolegët.

7. “Vërtetim besueshmërie” është akti administrativ, lëshuar nga struktura vendore e Policisë së Shtetit për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar nga kandidati për punonjës të Policisë Bashkiake, në raport me ato të regjistrave fizikë dhe elektronikë të policisë dhe institucioneve të tjera shtetërore.

8. “Vlerësimi i performancës” është procesi i vlerësimit të rezultateve në punë.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë

Parimet bazë, që udhëheqin Policinë Bashkiake në veprimtarinë e saj, janë:

- a) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- b) ligjshmëria;
- c) mosdiskriminimi;
- ç) proporcionaliteti;
- d) paanshmëria;
- dh) integriteti;
- e) merita dhe profesionalizmi;
- ë) transparenca;
- f) kontrolli dhe llogaridhënia.

KREU II

STATUSI, SIMBOLET, ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI, JURIDIKSIONI DHE KOMPETENCAT E POLICISË BASHKIAKE

Neni 5

Statusi i Policisë Bashkiake

1. Policia Bashkiake është institucion i administratës publike, me status të veçantë, përgjegjëse për fushën e sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarrëvajtjes së punëve publike, miradministrimit të hapësirave publike dhe mbrojtjes së mjedisit në territoret e njësisë të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë.

2. Statusi i Policisë Bashkiake nuk ndryshon edhe në gjendje lufte, gjendje të jashtëzakonshme apo të fatkeqësisë natyrore.

Neni 6

Simbolet

Policia Bashkiake ka uniformën, me shenjat dalluese përkatëse, flamurin dhe stemën e vet, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Punonjësit e Policisë Bashkiake

1. Punonjësit e Policisë Bashkiake, ndahen në dy kategori:

- a) punonjës operacional, drejtues, në nivel qendror ose vendor;
- b) punonjës në funksione administrative, në nivel qendror ose lokal.

2. Rregullat dhe procedurat për kërkesat e përgjithshme të pranimit, marrëdhëniet e punës, të trajnimit, ecurisë në karrierë dhe ndërprerjes së saj, për klasifikimin e niveleve, sipas funksioneve organike, përshkrimin e përgjithshëm të punës për çdo kategori, klasë dhe grup, si dhe emërtesat e pozicioneve përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake, të miratuar nga Këshilli i Ministrave

Neni 8

Organizimi i Policisë Bashkiake

1. Policia Bashkiake organizohet në nivel qendror dhe vendor. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Bashkiake përfaqëson nivelin qendror; Drejtoritë Vendore të Policisë Bashkiake në bashki përfaqësojnë nivelin vendor dhe organizohen në drejtori ose sektorë.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Bashkiake, në varësi të ministrit, përfaqëson autoritetin më të lartë teknik, mbikëqyrës dhe drejtues të Policisë Bashkiake. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Bashkiake organizohet në drejtori me funksione parandalimi, koordinimi, trajnimi dhe logjistike.

3. Drejtoria Vendore e Policisë Bashkiake, në nivel vendor është në varësi të kryetarit të bashkisë. Ajo përfaqëson strukturën bazë operationale për ushtrimin e kompetencave të Policisë Bashkiake në territorin që ka në juridiksion.

4. Çdo bashki është përgjegjëse për garantimin e funksionimit të Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake, në territorin që ka në juridiksion.

Neni 9

Ministri

1. Ministri është autoriteti përgjegjës për rendin e sigurinë publike, i cili, nën përgjegjësinë e tij dhe brenda drejtimeve kryesore të politikës shtetërore, përcakton drejtimet e veprimtarisë e të mbështetjes së Policisë Bashkiake në përmbushjen e misionit dhe të përgjegjësisë së saj.

2. Ministri:

a) përcakton objektivat për zbatimin e politikave të përgjithshme dhe të programit të qeverisë për ruajtjen e sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet në njësitë e vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë;

b) orienton zbatimin e politikave të veprimtarisë së Policisë Bashkiake, me qëllim rritjen dhe garantimin e sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjen e punëve publike, miradministrimin e hapësirave publike dhe mbrojtjen e mjedisit në territoret e njësisë të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë.

3. Ministri nxjerr udhëzime në zbatim të ligjit, për unifikimin e veprimtarisë së Policisë Bashkiake dhe për standardizimin e procedurave operationale, administrative dhe etike të saj, të cilat janë të detyrueshme për Policinë Bashkiake, si dhe për institucionet apo subjektet që bashkëpunojnë me të në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në nivel vendor.

Neni 10

Prefekti i Qarkut

1. Prefekti i qarkut është autoriteti përgjegjës për koordinimin dhe bashkërendimin e Policisë Bashkiake me organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore.

2. Prefekti i qarkut konsultohet me Drejtorinë e Përgjithshëm të Policisë së Bashkiake, Drejtorët e Drejtorive Vendore të Policive Bashkiake si dhe me Kryetarët e Bashkive nën juridiksionin e qarkut, për çështjet e sigurisë në komunitet.

3. Prefekti i raporton ministrit në mënyrë periodike për sigurinë në komunitet në nivel qarku.

4. Prefekti i qarkut është përgjegjës për të evituar konfliktin e kompetencave ndërmjet Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake, në rastet e konfliktit të kompetencave në bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Drejtorinë e Përgjithshëm të Policisë Bashkiake, vendos për çështjen.

5. Me urdhër të ministrit, Prefekti i qarkut mund të kryejë detyra të tjera, në kuadër të përgjegjësisë të ministrit të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji. Në këtë rast, prefekti i qarkut ushtron përgjegjësitë e deleguara nga ministri në territorin e qarkut.

Kryetari i bashkisë

Kryetari i bashkisë ka këto përgjegjësi:

- a) planifikon fondet e Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake, nga buxheti i bashkisë, për çdo vit;
- b) siguron funksionimin e Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake për ushtrimin e kompetencave brenda juridiksionit të bashkisë, përmes garantimit të ambienteve dhe pajisjeve për Drejtorinë Vendore të Policisë Bashkiake;
- c) organizon konsultime periodike me komunitetin, organizatat jofitimprurëse, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Bashkiake si dhe me strukturat vendore të Policisë së Shtetit për prioritetet dhe veprimtarinë e Policisë Bashkiake.
- ç) merr masa organizative e teknike dhe planifikon fonde financiare për rritjen e sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, edhe në projektet e veprave që hartohen dhe miratohen nga ana e Policisë Bashkiake.
- d) planifikon fonde për trajnimin, kualifikimin periodik dhe rritjen e aftësive profesionale të personelit të Policisë Bashkiake që ka në juridiksion.
- dh) vendos lidhje dhe bashkëpunon me partnerë ose dhurues të shteteve të tjera, për të siguruar asistencë teknike, kualifikime të specializuara për personelin e policisë Bashkiake, si dhe për furnizimin materialo-teknik të Policisë Bashkiake.
- e) konsultohet dhe koordinohet me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Bashkiake dhe Prefektin e Qarkut për çështjet e sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, për territorin e bashkisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Bashkiake

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Bashkiake ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- a) ndjekjen dhe analizimin e rendit dhe qetësisë publike në njësitë e vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë;
- c) planifikimin, bashkërendimin dhe koordinimin e veprimtarisë së Policive Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë;
- ç) përgatitje e planeve të zhvillimit të shërbimeve policore Bashkiake dhe hartimin e kërkesave për modernizimin e tyre, si dhe të programeve të veçanta në fushën e rendit e të sigurisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë;
- d) propozimin për planifikimin dhe rekrutimin e personelit të Policisë Bashkiake dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore në kuadër të tyre;
- dh) koordinimin dhe bashkëpunimin me Prefektin e Qarkut dhe Kryetarët e Bashkive të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për sigurinë dhe rendin në territorin e tyre;
- ë) bashkërendon dhe koordinon veprimtarinë e Policive Bashkiake të bashkive dhe urdhëron zbatimin e politikave të rendit dhe sigurisë në komunitet në rastet e veprimtarive komplekse të Policisë Bashkiake në ushtrimin e kompetencave brenda juridiksionit të saj.
- f) bashkëpunon dhe koordinon veprimtarinë e Policisë Bashkiake me strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit si dhe të institucioneve të tjera qendrore, për rritjen e rendit, sigurisë dhe qetësisë në komunitet.
- ë) përpunimin dhe analizën e të dhënave të mbledhura nga Policia Bashkiake dhe të statistikave zyrtare Bashkiake për rendin dhe sigurinë në njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- f) përgatitjen e studimeve e vlerësimeve, hartimin në mënyrë periodike të analizave të riskut dhe analizave të tjera në fushat e shërbimeve dhe veprimtarive policore Bashkiake;
- g) informimin në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet medias në lidhje me ngjarje, fenomene dhe veprimtari që kanë të bëjnë me fushat e përgjegjësisë saj dhe janë me interes për publikun;
- gj) kryerjen e detyrave të tjera për administrimin e Policisë Bashkiake, në përputhje me këtë ligj dhe aktet në zbatim të tij.

Neni 13

Drejtoria vendore e Policisë Bashkiake

1. Drejtoria vendore e Policisë Bashkiake është struktura operationale përgjegjëse për ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të Policisë Bashkiake në nivel vendor, në të gjitha bashkitë e vendit, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

2. Drejtoria vendore e Policisë Bashkiake, gjatë ushtrimit të kompetencave brenda juridiksionit të saj, koordinohet dhe merr udhëzime nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Bashkiake, Prefekti i Qarkut si dhe Kryetari i Bashkisë, i cili sugjeron prioritetet për rritjen e nivelit të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet.

3. Drejtoria vendore e Policisë Bashkiake, organizohet në drejtori dhe sektorë, sipas organikës së miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Bashkiake, në koordinim me Kryetarin e Bashkisë.

4. Drejtoria vendore e Policisë Bashkiake ushtron veprimtarinë në territorin e bashkisë përkatëse. Në rastet kur për ushtrimin e veprimtarisë së Policisë Bashkiake, vlerësohet e nevojshme dhe e domosdoshme mbështetja operationale, me urdhër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake, mund të asistohet nga Drejtoritë vendore të Policisë Bashkiake të bashkive fqinje, ose në koordinim dhe bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Prefektin e Qarkut, nga Policia e Shtetit.

Neni 14

Kompetencat dhe detyrat e Policisë Bashkiake

1. Policia Bashkiake, nëpërmjet Drejtorive vendore të Policisë Bashkiake në bashki, ushtron përgjegjësitë dhe funksionet e mëposhtme:

- a) siguron zbatimin e akteve rregullatore dhe akteve në zbatim të ligjit, të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak;
- b) parandalon, konstaton dhe shqyrton kundërvajtjet administrative përmes forcimit, inspektimit dhe monitorimit në zbatim të akteve të njërive të vetëqeverisjes vendore brenda territorit të juridiksionit të saj;
- c) merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile pranë bashkisë dhe prefektit të qarkut për kapërcimin e tyre;
- ç) bashkërendon me Prefektin e Qarkut dhe Kryetarin e Bashkisë së njërive të vetëqeverisjes vendore për mbikëqyrjen e sigurisë brenda territorit të juridiksionit të Qarqeve dhe Bashkive të Republikës së Shqipërisë;
- dh) në koordinim me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë Bashkiake dhe Prefektin e Qarkut, përcakton masat për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteve në territorin e juridiksionit të njërive të vetëqeverisjes vendore;
- e) verifikon zbatimin e ligjshmërisë dhe patrullimin periodik në bashkëpunim me Prefektin e Detar dhe Kryetarin e Bashkisë së njërive të vetëqeverisjes vendore përgjatë vijës bregdetare publike dhe në zonat çlodhëse të ujërave të brendshme në thellësi të territorit, për sigurinë në det, plazhe dhe në ujërat e brendshme në thellësi të territorit të juridiksionit të njërive të vetëqeverisjes vendore;
- f) monitoron respektimin e ndarjes së hapësirës së plazhit gjatë ushtrimit të veprimtarisë të çdo personi juridik apo fizik pranë stacioneve të plazhit në territorin e juridiksionit të njërive të vetëqeverisjes vendore;
- g) merr masa sigurie në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre si personel sigurie;
- gj) mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, për procedurat e zhvendosjes së individëve ose familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre;
- h) merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë, si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj, në përputhje me vendimin e Këshillit Bashkiak të njësisë së vetëqeverisjes vendore;
- i) mbikëqyr respektimin e normave etike detyruese të bashkëjetesës, të përcaktuara në rregulloren

- e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;
- j) mbështet organet e inspektimit për zbatimin e legjislacionit për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;
- k) siguron ekzekutimin e sanksioneve për lidhjen dhe zgjidhjen e kontratës së qirasë së banesave sociale me qira dhe kufizimet mbi banesat me kosto të ulët, të vendosura nga entet menaxhuese;
- l) bashkërendon punën me strukturat përkatëse kur konstaton veprimtari të paligjshme për mjedisin, natyrën, pyjet, biodiversitetin dhe florën e faunën e egër;
- ll) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të kontrollit mbi gjuetinë kur pengohen në kryerjen e detyrës;
- m) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të inspektimit që mbulojnë veprimtarinë e peshkimit;
- n) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit për mbrojtjen e liqeneve ndërkuftare, brigjeve të tyre, zonave ujëmbledhëse, si dhe veprimtaritë që ushtrohen në to;
- nj) në koordinim me strukturat përgjegjëse të inspektimit, asiston në verifikimin dhe kontrollimin e zbatimit të kërkesave mbi nivelin kufi të zhurmës së lejuar nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurma, në territorin e juridiksionit të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe kujdeset për ndërmarrjen e masave përkatëse në përputhje me legjislacionin në fuqi për zhurmat;
- o) siguron zbatimin e akteve që përcaktojnë kryerjen e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, në vende publike të përcaktuara paraprakisht nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- p) verifikon respektimin e normave ligjore në lidhje me përdorimin në tregje apo vende të autorizuar nga bashkia të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo të oxo-biodegradueshme dhe vendosjen e materialeve reklamuese të pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar drejtuar të miturve;
- q) mbështet dhe asiston strukturat përgjegjëse të taksave dhe tarifave vendore në veprimtarinë e tyre;
- r) siguron respektimin e normave ligjore në lidhje me ndalimin e pirjes së duhanit në mjetet e transportit publik, përfshirë taksitë dhe mjediset e përbashkëta, në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme;
- rr) siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;
- s) vëren dhe konstaton ndërtimet e kundërligjshme, njofton dhe mbështet menjëherë strukturën përgjegjëse ndërtimore e urbanistike të bashkisë dhe ose Strukturën Qendrore për Inspektimin – Inspektorati Qendror për Territorin, Mjedisin dhe Pyjet për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore;
- sh) siguron zbatimin e rregullave dhe procedurave për organizimin dhe funksionimin e shërbimit publik të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e juridiksionit të bashkisë;
- t) garanton zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi afishimin e materialeve propagandistike në vendet jashtë përcaktimeve të bëra, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore.
- th) kryen detyra të parashikuara me këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

Neni 15

Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet që përbëjnë kundërvajtje administrative janë të parashikuara në ligjet e veçanta dhe aktet e këshillit bashkiak.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake për shkeljet e konstatuara merr masa administrative bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore që parashikojnë kundërvajtje administrative.
3. Kur punonjësi i Policisë Bashkiake krijon dyshimin e arsyeshëm se një veprim ose mosveprim i një

personi fizik ose juridik përbën një kundërvajtje administrative, konstatimi i së cilës nuk është në kompetencën e saj dhe se nga ai veprim mund të shkaktohet një dëm i pariparueshëm dhe me pasoja të rënda ndaj interesit publik apo palëve të treta, për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin, punonjësi i strukturës konstatuese ka të drejtë të marrë masa për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të kundërvajtësit dhe të njoftojë organin përkatës për shkeljen e konstatuar.

4. Procedura për konstatimin dhe shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative nga Policia Bashkiake kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU III

PRANIMI, FORMIMI DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIEVE TË PUNËS TË PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE

Neni 16

Marrëdhëniet e punësimit të punonjësve të Policisë Bashkiake

Marrëdhëniet e punës së drejtuesve dhe të punonjësve të tjerë të Policisë Bashkiake rregullohen sipas këtij ligji dhe Kodit të Punës.

Neni 17

Kriteret e përgjithshme për pranim në Policinë Bashkiake

Kriteret për pranimin në Policinë Bashkiake të çdo personi janë si më poshtë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm të lartë;
- d) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;
- dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- e) të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;
- ë) të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.

Neni 18

Kriteret e veçanta për pranim në Policinë Bashkiake

Përveç kriterëve të përgjithshme, të përcaktuara në nenin 17 të këtij ligji, për pranim në Policinë Bashkiake zbatohen edhe kriteret e veçanta, si më poshtë:

1. Për punonjësit e Policisë Bashkiake, në nivel vendor, të cilët janë në pozicione të ulët drejtues:

a) të ketë përfunduar arsimin e lartë, në nivelin bachelor, në shkenca shoqërore, juridike, ekonomike ose institucionet arsimore të sigurisë;

b) të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune në administratën publike, Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, në profesionet e lira ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to në sektorin privat;

2. Për punonjësit e Policisë Bashkiake, në nivel qendror ose vendor, të cilët janë në pozicionin e mesëm drejtues:

a) të ketë përfunduar arsimin e lartë, në nivelin master profesional, në shkenca shoqërore, juridike, ekonomike ose institucionet arsimore të sigurisë;

b) të ketë të paktën 3 vite eksperiencë pune në administratën publike, Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, në profesionet e lira ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to në sektorin privat;

3. Për punonjësit e Policisë Bashkiake, në nivel qendror ose vendor, të cilët janë në pozicionin e lartë drejtues:

a) të ketë përfunduar arsimin e lartë, në nivelin master shkencor, në shkenca shoqërore, juridike, ekonomike ose institucionet arsimore të sigurisë;

b) të ketë të paktën 5 vite eksperiencë pune në administratën publike, Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, në profesione të lira ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to në sektorin privat;

4. Për punonjësit e Policisë Bashkiake, në nivel vendor, të cilët mbajnë pozicionin e Policit Lokal:

a) të jetë banor rezident i Bashkisë në juridiksionin e të cilës emërohet.

Neni 19

Pranimi në Policinë Bashkiake

1. Pranimi në Policinë Bashkiake bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale dhe mosdiskriminimit.

2. Pranimi kryhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur përmes një procesi përzgjedhës dhe testimi transparent e të drejtë.

3. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e kriterëve dhe aftësive profesionale të kandidatëve.

4. Rregullat dhe procedurat e detajuara të pranimit në Policinë Bashkiake përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.

Neni 20

Shpallja

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Bashkiake shpall pozicionet e lira, të cilat përcaktohen në nivel qendror nga drejtuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake, dhe në nivel vendor nga drejtuesi i Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake. Shpallja për të dyja nivelet publikohet në faqen zyrtare të portalin unik të rekrutimit të Policisë Bashkiake.

2. Shpallja në portalin unik përmban periudhën e aplikimit, dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, programin e konkurrimit, fazat e konkurrimit, numrin e vendeve vakante dhe mënyrën e vlerësimit të procesit përzgjedhës.

3. Rregullat dhe procedurat për funksionimin e portalit unik, përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.

Neni 21

Konkurrimi dhe komisioni përzgjedhës

1. Konkurrimi përfshin verifikimin paraprak të kandidatit, testimin me shkrim, testimin fizik dhe intervistën nga komisioni përzgjedhës.

2. Për konkurset në nivel qendror, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake krijon komisionin përzgjedhës i cili ka pesë anëtarë:

a) 1 (një) anëtarë nga drejtoria/sektori përgjegjës për burimet njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake;

b) 2 (dy) anëtarë të përzgjedhur nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake, në nivel drejtues pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake;

c) 2 (dy) anëtarë të caktuar me urdhër të ministrit, nëpunës civilë, pjesë e kategorisë së mesme drejtuese, pranë ministrisë përgjegjëse për rendin, njëri prej të cilëve kryeson komisionin.

3. Për konkurset në nivel vendor, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake krijon komisionin përzgjedhës i cili ka pesë anëtarë:

a) 1 (një) anëtarë nga drejtoria/sektori përgjegjës për burimet njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake;

b) 2 (dy) anëtarë, drejtues të Drejtorive Vendore të Policisë Bashkiake, të përzgjedhur nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake;

c) 2 (dy) anëtare të zgjedhur nga Kryetari i Bashkisë, nëpunës civilë, pjesë e kategorisë së mesme drejtuese, njëri prej të cilëve kryeson komisionin.

Anëtarët sipas shkronjës c), të pikës 3, të këtij neni, caktohen sipas juridiksionit të bashkisë për të cilën është bërë shpallja. Në rastet kur shpallja bëhet për disa Drejtori Vendore të Policisë Bashkiake, propozimi bëhet nga dy bashkitë me numrin më të madh të banorëve, ndërsa kryesues i komisionit është i propozuari nga bashkia me numrin më të madh të banorëve.

4. Komisioni përzgjedhës kryen procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve për të gjitha fazat, me përjashtim të fazës së testimit fizik, e cila kryhet nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

5. Testimi fizik kryhet sipas procedurave të përcaktuara nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike.

6. Anëtari i komisionit informon menjëherë Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake në rast dyshimi të pengesave ligjore sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative, për veten ose për anëtarët e tjerë të komisionit, që të mos marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes.

7. Në rast se anëtarët e përcaktuar të komisionit janë në kushtet e pamundësisë ligjore për të qenë anëtarë të tij, ata zëvendësohen me anëtarë të tjerë sipas përcaktimeve të pikës 2 dhe 3 të këtij neni.

8. Rregullat e detajuara për funksionimin e komisionit përzgjedhës përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.

Neni 22

Verifikimi paraprak i kandidatit

1. Komisioni përzgjedhës, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kriteret e përcaktuara në nenet 17 dhe 18 të këtij ligji, të përcaktuara edhe në shpalljen për konkurrim.

2. Në përfundim të verifikimit, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenet 17 dhe 18 të këtij ligji, renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në portalin unik dhe për konkurset në nivel vendor edhe në faqen zyrtare të Bashkisë dhe në ambientet e brendshme të saj.

3. Kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë në të cilën tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Lista administrohet nga drejtoria/sektori i burimeve njerëzore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar, njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore.

Neni 23

Testimi me shkrim

1. Testimi me shkrim shërben për të vlerësuar nëse kandidati zotëron njohuritë e nevojshme për kryerjen e detyrave të punonjësit të Policisë Bashkiake.

2. Testimi me shkrim hartohet, administrohet dhe vlerësohet me pikë nga komisioni përzgjedhës.

3. Në përfundim të testimit me shkrim, komisioni publikon zyrtarisht listën me rezultatet e testimit në rend zbritës në faqen zyrtare të Policisë Bashkiake dhe për konkurset në nivel vendor edhe faqen zyrtare të Bashkisë dhe në ambientet e brendshme të saj.

4. Kandidati që ka marrë mbi 60% të pikëve të përcaktuara për testimin me shkrim njoftohet për të vazhduar konkurrimin.

Neni 24

Testimi i aftësive fizike

1. Kandidatët që kalojnë testimin me shkrim i nënshtrohen testimit të aftësive fizike, i cili teston aftësitë psikomotorë të kandidatit, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca dhe koordinimi fizik.

2. Përmbytja e testimit të aftësive fizike dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve përgatiten nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë

publike.

3. Kandidati quhet fitues kur ka marrë mbi 60% të pikëve të përcaktuara për testimin e aftësive fizike.
4. Kandidatët fitues renditen sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm dhe njoftohen për intervistën

Neni 25

Intervista

1. Kandidati vlerësohet përmes intervistës lidhur me përshtatshmërinë dhe pranueshmërinë e tij për ushtrimin e detyrës.
2. Komisioni i bën kandidatit pyetje të strukturuar, të cilat testojnë formimin dhe aftësinë e tij.

Neni 26

Përfundimi i procesit të konkurrimit

1. Procedura e konkurrimit përfundon me intervistën. Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, komisioni liston kandidatët fitues.
2. Rezultati i përgjithshëm i kandidatit përcaktohet mbi shumatoren e rezultateve të arritura nga testimi me shkrim, testimi fizik dhe intervista. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen përkatesisht:
 - a) testimi me shkrim, 60 (gjashtëdhjetë) pikë;
 - b) testimi i aftësive fizike, 20 (njëzet) pikë;
 - c) intervista, 20 (njëzet) pikë.
3. Kandidatët renditen në listën përfundimtare sipas rezultateve të arritura në rend zbritës, sipas pikëve totale të marra.
4. Administrimi i listës së fituesve të nxjerrë nga Komisioni Përzgjedhës bëhet nga drejtoria/sektori i burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake dhe të Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake.
5. Lista e kandidatëve, që kanë rezultuar të suksesshëm, është e vlefshme për 1 (një) vit, duke filluar nga data e përfundimit të procesit të pranimit.

Neni 27

Ankimi

1. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankimin me shkrim në Komisionin Përzgjedhës për rezultatin e pikëve dhe renditjen në listën fituese. Afati i ankimit fillon brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga:
 - a) data e njoftimit individual të rezultatit të verifikimit paraprak të kandidatit;
 - b) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimit me shkrim;
 - c) data e njoftimit individual të rezultatit të testimit të aftësive fizike;
 - ç) data e njoftimit individual të rezultatit të vlerësimeve për kandidatët, të cilët kanë marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të përcaktuara.
2. Komisioni përzgjedhës njofton vendimin brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor.
3. Në përfundim të këtij afati, drejtoria/sektori i burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake publikon listën përfundimtare fituese

Neni 28

Emërimi i punonjësit të Policisë Bashkiake

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake emërohet nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake, pas shpalljes fitues nga procedura e konkurrimit.
2. Procedura e përzgjedhjes për kandidatët me eksperiencë në Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi përfshin vetëm fazën e verifikimit paraprak të kandidatëve dhe intervistën nga komisioni përzgjedhës.

3. Pas emërimit, punonjësi i Policisë Bashkiake i nënshtrohet periudhës tremujore të provës.
4. Punonjësi i Policisë Bashkiake gjatë periudhës së provës përfundon trajnimin e detyrueshëm 4-javor në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, sipas programit të miratuar për këtë qëllim nga institucioni arsimor.
5. Në përfundim të trajnimit të detyrueshëm, zhvillohet testimi me shkrim për përvetësimin e njohurive nga kandidati, bazuar në programin e trajnimit. Kandidati përfundon me sukses trajnimin e detyrueshëm nëse merr mbi 50% të pikëve të testimit.
6. Mos përfundimi me sukses i trajnimit të detyrueshëm përbën shkak për përfundimin e marrëdhënies së punës.
7. Në fund të periudhës së provës, duke u bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë dhe përfundimin me sukses të trajnimit të detyrueshëm, punonjësi i Policisë Bashkiake konfirmohet në detyrë. Ndaj vendimit për vlerësimin e rezultateve në punë, punonjësi në periudhë prove ka të drejtë të kërkojë shqyrtim të vlerësimit nga Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake.

Neni 29

Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i drejtorit të përgjithshëm të Policisë Bashkiake

1. Drejtori i përgjithshëm i Policisë Bashkiake është autoriteti më i lartë i Policisë Bashkiake dhe përgjigjet drejtpërdrejtë te ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike për realizimin e politikave, të performancës e të objektivave të përcaktuara.
2. Drejtori i përgjithshëm i Policisë Bashkiake emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
3. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike i propozon Këshillit të Ministrave kandidatin për drejtor të përgjithshëm të Policisë Bashkiake pas kryerjes së një procesi të konkurimit të hapur, të bazuar në parimet e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Rregullat e procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për drejtor të përgjithshëm të Policisë Bashkiake përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
4. Kandidati i propozuar për drejtor të përgjithshëm të Policisë Bashkiake, duhet të jetë njëri nga punonjësit e Policisë Bashkiake, Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura, Gardës së Republikës, që më së paku, mban njërën nga gradat e rolit të mesëm drejtues ose pozicionit të mesëm drejtues për punonjësin e Policisë Bashkiake, e që plotëson këto kritere:
 - a) të ketë shtetësi shqiptare;
 - b) të mos ketë qenë i dënuar për kryerjen e një veprë penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c) të mos ketë marrë masat disiplinore të përcaktuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 123 të ligjit 82/2024, brenda 5 (pesë) vjetëve të fundit;
 - ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
 - d) të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës, në përputhje me legjislacionin për konfliktin e interesit.
 - dh) të mos jetë subjekt i ndalimeve sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
5. Drejtori i përgjithshëm i Policisë Bashkiake qëndron në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, me të drejtë riemërimi, sipas rregullave të përcaktuara në këtë nen, edhe për një mandat të dytë.
6. Drejtori i përgjithshëm i Policisë Bashkiake pezullohet nga detyra me urdhër të ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit.
7. Drejtori i përgjithshëm i Policisë Bashkiake lirohet nga detyra, kur:
 - a) humbet shtetësinë shqiptare;
 - b) i përfundon afati i qëndrimit në detyrë dhe nuk riemërohet;
 - c) jep dorëheqjen;

- c) bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për ushtrimin e funksionit për një periudhë kohore mbi 6 (gjashtë) muaj;
 - d) plotëson moshën për pension;
 - dh) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
8. Drejtori i përgjithshëm i Policisë Bashkiake shkarkohet nga detyra kur:
- a) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) nuk përmbush objektivat strategjike ose ka performancë të ulët.
9. Lirimi dhe shkarkimi i drejtorit të përgjithshëm të Policisë Bashkiake bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.
10. Drejtori i përgjithshëm i Policisë Bashkiake, pas përfundimit të afatit të qëndrimit në detyrë, rikthehet në strukturat e Policisë së Shtetit, në të njëjtën gradë që kishte përpara emërimit.

Neni 30

Emërimi, lirimi dhe shkarkimi i drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake

1. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake është autoriteti më i lartë i Policisë Bashkiake në nivel vendor dhe përgjigjet drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm i Policisë Bashkiake për realizimin e politikave, të performancës e të objektivave të përcaktuara në nivel vendor.
2. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake emërohet me vendim të Kryetarit të Bashkisë, i cili për zgjedh ndërmjet listës së kandidatëve të propozuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Bashkiake, pas kryerjes së një procesi të konkurimit të hapur, të bazuar në parimet e mundësive të barabarta, meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Rregullat e procedurat për zgjedhjen e kandidatit për drejtor të përgjithshëm të Policisë Bashkiake përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Bashkiake.
3. Kandidati për drejtues vendor i Policisë Bashkiake, përveç kritereve të përcaktuara në nenin 16 dhe në pikën 3, të nenit 17 të këtij ligji, plotëson edhe kriteret e mëposhtme:
 - a) të mos jetë subjekt i ndalimeve sipas legjislacionit në fuqi për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
4. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake qëndron në detyrë për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh, me të drejtë riemërimi, sipas rregullave të përcaktuara në këtë nen, edhe për një mandat të dytë.
5. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake pezullohet nga detyra me vendim të Kryetarit të Bashkisë kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një vepre penale;
 - b) ai merr cilësinë e të pandehurit.
6. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake lirohet nga detyra, kur:
 - a) humbet shtetësinë shqiptare;
 - b) i përfundon afati i qëndrimit në detyrë dhe nuk riemërohet;
 - c) jep dorëheqjen;
 - c) bëhet i paaftë nga ana shëndetësore për ushtrimin e funksionit për një periudhë kohore mbi 6 (gjashtë) muaj;
 - d) plotëson moshën për pension;
 - dh) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
8. Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake shkarkohet nga detyra kur:
 - a) dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) nuk përmbush objektivat strategjike ose ka performancë të ulët.
9. Lirimi dhe shkarkimi i drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake bëhet me vendim të Kryetarit të Bashkisë, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Bashkiake.

Neni 31

Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Bashkiake

Drejtori i përgjithshëm i Policisë Bashkiake ushtron këto përgjegjësi dhe detyra:

- a) organizon, drejton dhe kontroll veprimtarinë e Policisë Bashkiake në nivel qendror;
- b) drejton në bashkëpunim me drejtuesin vendor të Policisë Bashkiake përgatitjen e krijimit të kapaciteteve të shërbimeve policore Bashkiake në nivel vendor dhe garantimin e efektivitetit të tyre në përmbushjen e përgjegjësisë;
- c) i propozon Ministrin përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike kërkesat buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Bashkiake;
- ç) harton në bashkëpunim me Kryetarin e Bashkisë dhe Drejtuesin Vendor të Policisë Bashkiake planet e zhvillimit të shërbimeve policore vendore, kërkesat për modernizimin e tyre si dhe programe të veçanta në fushën e rendit dhe të sigurisë vendore;
- dh) informon Drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ministrin përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, ministrin për pushtetin vendor lidhur me problematikat në fushën e rendit dhe të sigurisë vendore;
- e) koordinon veprimet e Policisë Bashkiake me Prefektët e Qarqeve dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) përgatit në bashkëpunim me Drejtuesin Vendor raportin vjetor mbi arritjet e Policisë Bashkiake dhe identifikon fushat përkatëse që kanë nevojë për përmirësim.
- g) nxjerr akte administrative brenda detyrave dhe përgjegjësisë që ka;
- gj) ushtron detyra dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Neni 32

Përgjegjësitë dhe detyrat e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake

Drejtuesi Vendor i Policisë Bashkiake ushtron këto përgjegjësi dhe detyra:

- a) organizon, drejton, kontrollon dhe përgjigjet për sigurimin e zbatimit të detyrimeve dhe kompetencave që ka Policia Bashkiake;
- b) koordinon veprimtarinë e punës me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë Bashkiake për zbatimin e detyrimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e rendit e të sigurisë publike në parandalimin e veprimtarive të kundërligjshme për aktivitetet që zhvillohen në territorin e bashkisë;
- c) planifikon aktivitetin në mbështetje të detyrave të caktuara për të siguruar realizimin në kohë të objektivave të përcaktuara;
- ç) kryen analiza, raporte, përshkrime që lidhen me veprimtarinë e Policisë Bashkiake në nivel vendor;
- d) i propozon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Bashkiake kalendarin e trajnimeve për të siguruar kualifikimin periodik profesional të punonjësve të Policisë Bashkiake në nivel vendor;
- dh) këshillon kryetarin e bashkisë dhe jep mendime për zgjidhjen e çështjeve në fushën e përgjegjësisë së tij.

Neni 33

Lirimi dhe shkarkimi i drejtuesit dhe punonjësve të Policisë Bashkiake

1. Punonjësi i Policisë Lokal, në nivel qendror dhe vendor lirohet nga detyra në rastet kur:
 - a) jep dorëheqjen;
 - b) mbush moshën e pensionit të pleqërisë;
 - c) bëhet i paafte përgjithmonë për të kryer detyrën për shkak të gjendjes shëndetësore;
 - ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
 - d) vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij.
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake, në nivel qendror dhe vendor, shkarkohet nga detyra në rastet kur:
 - a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b) merret masa disiplinore e largimit nga Policia Bashkiake pasi kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;
 - c) nuk përmbush detyrat e punës ose ka performancë të ulët së paku në dy vlerësime radhazi;
 - ç) humbet shtetësinë shqiptare;
 - d) merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar.

4. Lirimi dhe shkarkimi i punonjësit të Policisë Bashkiake, në nivel qendror, bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Bashkiake. Në nivel vendor, procedura fillon me propozimin e Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake, vendimi përfundimtar i lirimit ose i shkarkimit merret nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Bashkiake.
5. Për rastin e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 3 të këtij neni, shkarkimi i punonjësit të Policisë Bashkiake, sipas pikës 4 të këtij neni, bëhet me propozim të Komisionit të Disiplinës.

Neni 34

Vlerësimi i performancës

1. Vlerësimi i rezultateve në punë përfshin verifikimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të punonjësit të Policisë Bashkiake.
2. Vlerësimi i rezultateve në punë të punonjësit të Policisë Bashkiake bëhet çdo vit nga eprori i drejtpërdrejtë dhe miratohet, në nivel qendror, nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Bashkiake, dhe në nivel vendor, nga Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake.
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake vlerësohet në një nga këto nivele:
 - a) jokënaqshëm, në rastet kur punonjësi nuk i ka realizuar objektivat dhe nuk ka përmbushur pritshmëritë lidhur me qëndrimin dhe sjelljen profesionale;
 - b) kënaqshëm, në rastet kur punonjësi ka realizuar kënaqshëm objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional relativisht të mirë;
 - c) mirë, në rastet kur punonjësi ka realizuar mirë objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional të mirë;
 - ç) shumë mirë, në rastet kur punonjësi ka realizuar shumë mirë të gjitha objektivat dhe ka treguar një sjellje dhe qëndrim profesional të dalluar nga të tjerët.
4. Rregullat e detajuara për procedurën e vlerësimit dhe formati i formularit të vlerësimit të rezultateve të punës përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.
5. Punonjësi i Policisë Bashkiake, kur nuk është dakord me vlerësimin përfundimtar të rezultateve në punë, ka të drejtë të kërkojë shqyrtim të vlerësimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Bashkiake.
6. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Bashkiake shqyrton ankimin brenda 5 (pesë) ditëve dhe bën vlerësimin përfundimtar, i cili shënohet dhe nënshkruhet nga ky i fundit në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë.
7. Pas përfundimit të ankimit administrativ, punonjësi ka të drejtë e ankimit në gjykatën kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 35

Trajnimet

1. Trajnimet e punonjësit të Policisë Bashkiake bëhen në mënyrë periodike në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ose në institucione të tjera publike.
2. Drejtorja e Përgjithshme e Policisë Bashkiake bashkëpunon me institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni për miratimin dhe zbatimin e programit të formimit të vazhdueshëm, me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale.
3. Kryetari i Bashkisë mund të propozojë organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve të punonjësve të Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake, në juridiksionin e tij.
3. Kostot e trajnimit përballohen nga buxheti Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake.

Neni 36

Trajtimi financiar i punonjësve të Policisë Bashkiake

Pagat e punonjësve të Policisë Bashkiake, në nivel qendror dhe vendor, miratohen nga Ministri, në përputhje me legjislacionin në fuqi për pagat dhe shpërblimet, dhe përballohen nga buxheti i shtetit.

KREU IV

DETYRIMET DHE TË DREJTAT E PUNONJËSIT TË POLICISË BASHKIAKE

Neni 37

Detyrimi për respektimin e ligjit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake respekton Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si dhe mbron të drejtat e liritë e njeriut.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake mban përgjegjësi individuale për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij gjatë ushtrimit të detyrës.
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake kryen detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi dhe pa diskriminim.

Neni 38

Detyrimi për të zbatuar urdhrin

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake vepron në përputhje me urdhrat e marrë nga eprorët hierarkikë, sipas ligjit dhe rregullave të Policisë Bashkiake.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake, nëse dyshon për paligjshmërinë e urdhrin të eprorit, ai nuk e zbaton atë, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake zbaton urdhrin me shkrim, me përjashtim të rastit kur zbatimi i tij përbën vepër penale.

Neni 39

Detyrimi për të zbatuar rregullat e etikës dhe sjelljes profesionale

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake respekton rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave, të cilat përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.
2. Gjatë ushtrimit të detyrave të tij, punonjësi i Policisë Bashkiake i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore në rastet e parashikuara në këtë ligj

Neni 40

Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk përdor informacionin e mbledhur gjatë ushtrimit të detyrës për qëllime të tjera, jashtë atyre të përcaktuara me ligj.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake siguron mbrojtjen, ruajtjen, mospërhapjen, si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe atyre që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të personave, të mbrojtura sipas ligjit, me të cilat njihet gjatë ushtrimit të detyrës, edhe pas mbarimit të ushtrimit të detyrës.

Neni 41

Detyrimi për administrimin e pronës dhe kohën e punës

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake miradministron pronën, pajisjet dhe mjetet që i vihen në përdorim në ushtrimin e detyrës dhe i përdor ato vetëm për qëllimin e përcaktuar.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake shfrytëzon kohën e punës dhe shërbimit me efektshmëri dhe vetëm për kryerjen e detyrave.

Neni 42

Kufizimi për veprimtari të dyta

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk punësohet ose kryen veprimtari private që bie ndesh me detyrën e punonjësit të Policisë Bashkiake, me përjashtim të mësimdhënies.

2. Në rastet e mësimdhënies, punonjësi i Policisë Bashkiake merr miratimin me shkrim të drejtuesit.

Neni 43

Konflikti i interesit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake shmang çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në kryerjen e detyrës sipas legjislacionit përkatës.

2. Punonjësi i Policisë Bashkiake informon menjëherë eprorin në rast dyshimi për një konflikt interesi dhe zbaton urdhrat e tij.

3. Eprori merr masa të shmangë konfliktin e interesit të deklaruar nga punonjësi.

Neni 44

Të drejtat politike

1. Policia Bashkiake është strukturë e depolitizuar.

2. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk mund të jetë anëtar i partive politike.

3. Punonjësi i Policisë Bashkiake nuk duhet të shprehë publikisht bindjet ose preferencat e tij politike gjatë kohës së ushtrimit të detyrës

Neni 45

E drejta e anëtarësimit në organizata sindikale

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake ka të drejtën e pjesëmarrjes në organizata sindikale dhe veprimtari sindikale, që kanë për qëllim mbrojtjen e interesave të tij në marrëdhënien e punës.

2. Marrëdhëniet ndërmjet organizatave sindikale dhe punonjësve të Policisë Bashkiake rregullohen nëpërmjet statutit të sindikatës dhe kartës së të drejtave dhe detyrimeve që pranon çdo punonjës i Policisë Bashkiake kur anëtarësohet.

KREU V

PROCEDIMI DISIPLINOR NË POLICISË BASHKIAKE

Neni 46

Shkeljet disiplinore

1. Shkelje disiplinore është çdo veprim ose mosveprim i punonjësit të Policisë Bashkiake gjatë ushtrimit të detyrës apo për shkak të saj, që bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, nëse ajo nuk përbën vepër penale.

2. Shkeljet disiplinore janë:

a) shkelje të lehta;

b) shkelje të rënda.

3. Shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 3 (tre) vjetëve nga koha kur ka ndodhur shkelja.

Neni 47

Llojet e shkeljeve disiplinore

1. Janë shkelje të rënda:

a) mospërmbyllja e detyrave;

b) braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për 3 (tri) ditë pune ose më shumë;

c) shkelja e përsëritur e rregullave të etikës;

ç) sjellja e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun;

d) dëmtimi me dashje i pronës shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pronës shtetërore, veçanërisht nëpërmjet përdorimit të mjeteve lëvizëse apo pajisjeve të Policisë Bashkiake për interesa private ose lejimi i përdorimit të tyre prej personave të tjerë;

- dh) përfitimi i padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat jepen për shkak të detyrës që ushtron ose si rrjedhojë e shfrytëzimit të statusit si punonjës i Policisë Bashkiake;
 - e) shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla;
 - ë) moszbatimi i urdhrave të ligjshëm të eprorëve, kur kanë sjellë pasoja;
 - f) ushtrimi i detyrës në kushtet e konfliktit të interesit;
 - g) shkelja e kërkesave dhe e rregullave për garantimin e rendit dhe të sigurisë në komunitet;
 - gj) paraqitja në detyrë ose shërbim nën efektet e alkoolit ose të lëndëve narkotike apo konsumimi i tyre gjatë kryerjes së detyrës;
 - h) mosmarrja e masave nga eprorët për rastet e konstatuara të ngacmimeve seksuale ose për të cilat është vënë në dijeni;
 - i) lejimi i përdorimit të dokumentit të identifikimit nga persona të tjerë;
 - j) mospërdorimi i uniformës dhe shenjave dalluese gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj;
 - k) mosinformimi i eprorëve për fillimin e procedimit penal ndaj tij;
 - l) përsëritja e një shkeljeje të lehtë disiplinore për të cilën është në fuqi një masë disiplinore.
2. Janë shkelje të lehta:
- a) mungesa e pajustificuar në punë deri në 3 (tri) ditë pune;
 - b) shkelja e rregullave të etikës për Policinë Bashkiake;
 - c) sjellja e parregullt gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun;
 - ç) moszbatimi i urdhrave të ligjshëm të eprorëve;
 - d) ndërhyrja ose ndikimi i padrejtë në ushtrimin e detyrës së një punonjësi tjetër të Policisë Bashkiake;
 - dh) komunikimi me median apo me persona të tjerë pa miratimin e drejtuesit të Policisë Bashkiake;
 - e) mbajtja apo përdorimi i dokumentit identifikues të pamiratur nga autoriteti përkatës, si punonjës i Policisë Bashkiake;
 - ë) kryerja e akteve dhe sjelljeve të papërshtatshme gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e punonjësit të Policisë Bashkiake ose që dëmtojnë rëndë besimin e publikut në Policinë Bashkiake.

Neni 48

Procedura disiplinore

1. Masat disiplinore merren nga organi disiplinor sipas një procedure transparente, e cila i garanton punonjësit të Policisë Bashkiake të drejtën për t'u informuar, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.
2. Për shkelje të lehta disiplinore masa merret nga eprori direkt për punonjësin e Policisë Bashkiake.
3. Për shkelje të rënda disiplinore, masa merret nga Komisioni i Disiplinës për punonjësin e Policisë Bashkiake.
4. Komisioni i Disiplinës, për punonjësit e Policisë Bashkiake, në nivel qendror, përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka në përbërje:
 - a) nëpunësin më të lartë civil në ministrinë përgjegjëse për rendin;
 - b) eprorin direkt të punonjësit për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;
 - c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake;
 - ç) nëpunësin më të vjetër të ministrisë përgjegjëse për rendin;
 - d) punonjësin më të vjetër në strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake.
5. Komisioni i Disiplinës, për punonjësit e Policisë Bashkiake, në nivel vendor, përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka në përbërje:
 - a) nëpunësin më të lartë civil në bashkinë, nën juridiksionin e të cilës vepron Drejtoria Vendore e Policisë Bashkiake ;
 - b) eprorin direkt të punonjësit për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

- c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake;
 - ç) nëpunësin më të vjetër të administratës së bashkisë;
 - d) punonjësin më të vjetër në strukturën e Drejtorisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake.
5. Komisioni i Disiplinës, në nivel qendror, ngrihet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë Bashkiake, ndërsa në nivel vendor, ngrihet me urdhër të Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake, dhe mbledhet, organizohet dhe funksionon në bazë të legjislacionit që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale.
6. Rregullat e hollësishme për procedimin disiplinor në Policinë Bashkiake përcaktohen në rregulloren kuadër të Policisë Bashkiake.

Neni 49

Fillimi i hetimit disiplinor

1. Hetimi disiplinor ndaj punonjësit të Policisë Bashkiake fillon kryesisht ose me ankesë, bazuar në informacione prej të cilave lindin dyshime të arsyeshme mbi kryerjen e një shkeljeje disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës.
2. Eprori direkt vlerëson paraprakisht informacionin e marrë për shkeljen e pretenduar. Nëse nuk rezulton të ketë elemente që mund të përcaktohen si shkelje disiplinore, vendos të mos e fillojë procedurën disiplinore.
3. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente që përcaktohen si shkelje disiplinore, eprori direkt bën klasifikimin e shkeljeve sipas pikës 2 të nenit 44 të ligjit.
4. Në rast se shkelja klasifikohet në shkeljet e lehta, eprori direkt fillon procedurën disiplinore dhe në rast se shkelja klasifikohet e rëndë, procedura disiplinore fillon nga Komisioni Disiplinor.
5. Organi disiplinor fillon procedimin disiplinor dhe njofton me shkrim punonjësin përkatës.

Neni 50

Zhvillimi i procedimit disiplinor

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake është palë në proces që nga momenti i fillimit të hetimit dhe atij i garantohet akses i dosjen e hetimit.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake ka të drejtën për t'u dëgjuar ai vetë apo me përfaqësues ligjor, për të paraqitur dëshmitarë e prova ose për të kërkuar marrjen e tyre.
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake ka të drejtë për të paraqitur me shkrim sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar.
4. Organi disiplinor për dhënien e masës disiplinore i kërkon punonjësit të Policisë Bashkiake të paraqesë çdo lloj prove, si dhe të marrë pjesë në seancë dëgjimore.
5. Organi disiplinor, pasi shqyrton çështjen, vendos marrjen e masës disiplinore, mosmarrjen e masës disiplinore ose ndërprerjen e ecurisë disiplinore.

Neni 51

Ndërprerja e ecurisë disiplinore

1. Organi disiplinor mbyll hetimin dhe ndërpret ecurinë disiplinore nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se:
 - a) provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore;
 - b) çështja ka qenë objekt i një hetimi të mëparshëm, që është mbyllur ose për të cilën është dhënë vendim i formës së prerë, në kuadër të një procedimi disiplinor;
 - c) çështja është parashkruar në kohën kur është filluar hetimi për shkak të kalimit të afateve;
 - ç) punonjësi i Policisë Bashkiake ka vdekur ose është shpallur i vdekur me vendim gjykatë.
2. Organi disiplinor i njofton vendimin për ndërprerjen e ecurisë disiplinore titullarit të institucionit, punonjësit të Policisë Bashkiake ose përfaqësuesit të tij, i cili përmban arsyet për mbylljen e hetimit sipas pikës 1 të këtij neni.

Masat disiplinore

1. Ndaj punonjësit të Policisë Bashkiake, që kryen shkelje disiplinore, merren këto masa:
 - a) për shkelje të lehta disiplinore:
 - i. vërejtje;
 - ii. vërejtje me paralajmërim.
 - b) për shkelje të rënda disiplinore:
 - i. mbajtjen deri në 1/4 e pagës së plotë për një periudhë deri në tre muaj;
 - ii. largimin nga Policia Bashkiake.
2. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore. Në rastin kur kemi më shumë se një shkelje disiplinore dhe kur shkeljet e konstatuara sanksionohen me masa të ndryshme disiplinore, jepet masa më e rëndë.
3. Marrja e masës disiplinore bazohet në kriteret e mëposhtme:
 - a) shkalla e përgjegjësisë dhe fajit;
 - b) shpeshësia e kryerjes së shkeljes;
 - c) rrethanat e kryerjes së shkeljes, mundësia e ardhjes së pasojave, si dhe dëmi i shkaktuar nga shkelja.
4. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve:
 - a) 6 (gjashtë) muaj për masën “vërejtje” dhe “vërejtje me paralajmërim”;
 - b) 3 (tre) vjet nga njoftimi i masës së parashikuar sipas nënndarjes “i” të shkronjës “b” të pikës 1 të këtij neni.
5. Masa disiplinore “Largim nga Policia Bashkiake” qëndron përgjithmonë në dosjen personale të ish-punonjësit të Policisë Bashkiake.
6. Deklarimi i shuarjes bëhet kryesisht apo me kërkesë, me vendim të njësisë së burimeve njerëzore të bashkisë dhe masa fshihet nga dosja e personelit.

Ankimi

1. Vendimi jepet me shkrim, i arsyetuar, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.
2. Punonjësi i Policisë Bashkiake ka të drejtë ta ankimojë vendimin për masën disiplinore në gjykatën kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU VI

UNIFORMA, SHENJAT DALLUESE, PAJISJET DHE MJETET

Uniforma dhe shenjat dalluese

1. Punonjësi kryen detyrat e shërbimit me uniformë dhe shenja dalluese të veçanta.
2. Policia Bashkiake ka stemën dhe shenjën dalluese unike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat përdoren në uniformën e Policisë Bashkiake .
3. Punonjësi i Policisë Bashkiake përdor uniformën dhe shenjat dalluese vetëm gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj.
4. Punonjësi i Policisë Bashkiake gjatë kryerjes së detyrës identifikohet me dokumentin individual të identifikimit.
5. Policia Bashkiake në çdo bashki ka uniformë të njëjtë, të ndryshme nga çdo strukturë tjetër policore si dhe krahas stemës dhe shenjës dalluese unike, të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, mban edhe stemën dhe flamurin e Bashkisë.
6. Uniforma, shenjat dalluese dhe modeli i dokumentit individual të identifikimit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 55

Mjetet e Policisë Bashkiake

1. Policia Bashkiake gjatë ushtrimit të detyrës përdor mjete lëvizëse.
2. Këshilli i Ministrave miraton me vendim ngjyrën, shenjën dhe përdorimin e tyre.

KREU VII

MASAT PËR RUAJTJEN E RENDIT DHE SIGURISË PUBLIKE NË KOMUNITET

Neni 56

Kontrolli i identitetit

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake kontrollon identitetin e personit, kur:
 - a) në gjendjen e flagrancës konstatohet se po kryen një kundërvajtje administrative;
 - b) ndaj tij është paraqitur një kërkesë me dyshimin se është kryer një shkelje administrative;
 - c) është i dyshuar për cenim të rendit dhe sigurisë në komunitet, për kompetencat dhe detyrat e parashikuara në nenin 13 të këtij ligji.
2. Për një identifikim të besueshëm të personit, punonjësi i Policisë Bashkiake bazohet në dokumentet ligjore të identifikimit.
3. Gjatë procedurës së verifikimit, Policia Bashkiake ka të drejtë të kërkojë ndihmën e Policisë së Shtetit për kontrollin e identitetit, sipas rasteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni.

Neni 57

Bllokimi i rrugëve

Për nevoja të rendit dhe të sigurisë publike ose në rastet e fatkeqësive natyrore apo të aksidenteve, Policia Bashkiake vë në dispozicion të Policisë së Shtetit punonjësit e saj dhe mjetet për bllokimin e një pjese të rrugëve ose të mjediseve publike brenda juridiksionit të bashkisë deri në kryerjen e veprimeve të nevojshme ligjore.

Neni 58

Masat mbrojtëse

1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit me çrregullime të shëndetit mendor, në gjendje të dehur ose nën efektet e lëndëve narkotike.
2. Në këto raste, punonjësi i Policisë Bashkiake njofton Policinë e Shtetit dhe, në rastet kur gjendja e tij përbën rrezik për jetën e tij, shëndetin ose sigurinë e vetes ose të të tjerëve, e shoqëron personin në shërbimin e urgjencës mjekësore më të afërt.
3. Veprimet e sipërpërmendura për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në pikën 1 të këtij neni dokumentohen në procesverbal.

Neni 59

Bashkërendimi me organet publike

1. Policia Bashkiake bashkëpunon dhe bashkërendon punën me organet publike, personat juridikë dhe fizikë, në përmbushje të detyrave funksionale, të përcaktuara edhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjore.
2. Policia Bashkiake bashkërendon punën me Policinë e Shtetit në drejtim të shkëmbimit të informacionit, në funksion të parandalimit të krimit në bashkinë përkatëse.

KREU VIII

DISPOZITA E FUNDIT

Neni 60

Dispozita kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Policinë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore suprimohen, dhe i

nënshtrohen riorganizimit sipas parashikimeve të këtij ligji, brenda periudhës tranzitore prej 6 muajsh, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

2. Ministri përgjegjës për financat gjatë periudhës tranzitore, përgatit vlerësimin e efekteve financiare për funksionalizimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Bashkiake, dhe jo më larg se 3 muaj nga miratimi i këtij ligji, i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e kostos financiare të funksionalizimit të saj, e cila mbulohet nga buxheti i shtetit.

Neni 61

Miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 6, nenit 7, pika 2, nenit 54, pika 6 dhe nenit 55, pika 2, të këtij ligji brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 62

Shfuqizime

Ligji nr.89/2022, “Për Policinë Bashkiake”, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij shfuqizohen.

Neni 63

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare